

Sigurisht që miratimi i të dyja projektligjeve sot, që kanë të bëjnë me anëtarësinë në dy konventa, janë të rëndësishme, janë detyrë për shtetin, për përafrimin me direktivat, por të mos harrojmë që janë, në fakt, edhe një vullnet dhe një vëmendje e shtuar, sepse asnjëherë nuk mjafton, nuk bëjmë sa duhet për ruajtjen, mbrojtjen e mjedisit dhe për sigurinë e tij qoftë në tokë, qoftë në det. Sigurisht, edhe miratimi i të dyja projektligjeve sot synon reduktimin e efekteve negative ndotëse dhe rritjen e sigurisë në hapësirat tona ujore, detare, por jo vetëm kaq. Edhe projektligji, që kemi në diskutim në komisione dhe që shumë shpejt do të vijë për miratim në këtë sallë, i cili ka të bëjë me ndalimin e shitjes, tregtimit, prodhimit dhe të importimit të qeseve plastike njëpërdorimshe, i shërben të njëjtit qëllim në shkallën më të lartë, si për të miratuar dhe për të mbështetur direktivat, ashtu edhe për të rritur menaxhimin dhe qeverisjen e një problemi të trashëguar, siç janë mbetjet, mbetje të dëmshme, si ato plastike.

Megjithatë, pa u ndalur te politizimi i mbetjeve, që të gjitha opozitat përpiqen t'ia marrin njëra-tjetrës si një kalë beteje, në mungesë të kauzave reale politike, është për t'u vlerësuar fakti se menaxhimi i mbetjeve në shkallë vendi është sjellë gjithmonë e më shumë në vëmendjen e opinionit publik, dhe unë, në fakt, opinionit publik dhe publikut dua t'i drejtohem, sepse aktet, që miratojmë, edhe këto të dyja, për të cilat u dakordësuam të gjitha palët për hir të përafrimit me direktivat europiane apo me konventat ndërkombëtare, nuk janë thjesht kusht për përafrim me direktivat, por janë kauza sociale; janë kauza për ndërgjegjësim; janë çështje që duhen zgjidhur nga kjo qeveri dhe nga kjo forcë politike që mandatohet për të tretën herë, pikërisht sepse është e vetmja forcë që ngjall besim, por edhe sepse është e vetmja forcë që çështjen e mjedisit, çështjen e menaxhimit të mbetjeve e ka marrë më seriozisht se askush tjetër, sepse ndotjet qofshin në det, në tokë apo në hapësirat të tjera ujore, nuk zhduken kurrësi duke bërë sikur nuk i shohim, sikur nuk ekzistojnë, ndërkohë që shtohen sa më gjatë jetojmë, ndërkohë që shtohen sa më mirë jetojmë, ndërkohë që shtohen sa më shumë konsumojmë. Edhe për këtë duhet të japim llogari këtu.

Në fakt, të përmirësosh cilësinë e jetës, do të thotë, gjithashtu, edhe të parandalosh ndotjet e mëtejshme, do të thotë ta përmirësosh cilësinë e menaxhimit të mbetjeve, të përmirësosh standardin e shërbimeve, të rrisësh shkallën e administrimit të mbetjeve që ne vetë prodhojmë si shoqëri, të nxisësh dhe të zhvillosh ekonominë e zhvillimit të turizmit, që e pranojmë të gjithë se është një degë e rëndësishme e zhvillimit të ekonomisë. Kjo do të thotë ta kesh prioritet pastrimin e hapësirave urbane, rurale dhe administrimin e mbetjeve. Në vitin 2013, mjedisi, për më tepër menaxhimi i mbetjeve, nuk konsiderohej nga askush deri në atë kohë as si një urë lidhëse për zhvillimin ekonomik dhe promovimin e turizmit, as mendohej si prioritet për shëndetin, mjedisin, për cilësinë e tokës e të ujit që duket se ishin terma që kishin dalë edhe nga fjalori dhe ligjërimi publik, madje mjedisi nuk ishte fare temë e ligjërimit publik, as politik, por as social. Dukej se ishim mësuar që plehrat të mos i shihnim edhe kur shkelnim mbi to, për më tepër kur i kemi në fund të detit, siç vazhdojmë t'i kemi, prandaj po ndërmarrim iniciativën ligjore për ndalimin e prodhimit të qeseve. 9 vjet më parë, panorama e menaxhimit dhe e ndërgjegjësimit të mbetjeve ishte krejt tjetër.

Kjo duket qartë, pasi u trashëguan venddepozitetet nga 300 e ca ish-komuna, të cilat në pjesën më të madhe ishin krijuar historikisht ose ishin harruar në brigjet lumore apo në vende, të cilat ishin jashtë çdo standardi mjedisor, duke ndotur lumenjtë, pastaj detet, sikundër edhe shumë vende të tjera të

paligjshme dhe të rrezikshme depozitimesh për mbetjet në bashkitë ekzistuese, çibanë, në fakt, që vazhdojnë ende sot të trashëguara prej 30 vjetësh në periferitë e qyteteve, të fshatrave apo diku mbrapa malit, sepse mendojmë gabimisht që mjafton të kemi qendrat urbane të pastra, mjafton të kemi sheshet nëpër hapësirat tona rurale dhe quhemi të pastër. Jo, nuk mjafton, të nderuar kolegë. Nuk ka pasur një metodologji të qartë dhe të unifikuar për të përcaktuar sa na kushton pastrimi i mbetjeve; sa na kushton menaxhimi i tyre; ku shkon qesja me plehra, pasi ne e hedhim dhe e nxjerrim nga shtëpia, nga restoranti, nga biznesi. Nuk kemi pasur as tarifa reale për këtë shërbim dhe, sigurisht, nuk kishim as llogaritje se sa i kushton një bashkie, as perceptim dhe informim të publikut se sa i kushton ekonomisë shqiptare. Mjafton të thuash se i hedh mbetjet diku tej, larg meje, larg shtëpisë sime, si të ishte thjesht një proces biologjik dhe nuk është folur për menaxhim publik të mbetjeve. Duke thënë këtë, madje edhe vetë bashkitë nuk e kishin prioritet administrimin e mbetjeve, sepse, po të shikosh shifrat se si janë buxhetuar për shumë vjet nga bashki të ndryshme, asnjëherë nuk ka qenë konsideruar si një zë prioritar. Pamjaftueshmëria financiare, që reflektohej në mungesën e infrastrukturës së menaxhimit të mbetjeve, 9 vjet më parë ishte realitet, ishte normalitet. Kujtoj këtu që para vitit 2013 Shqipëria kishte vetëm një pikë fundore të trajtimit të mbetjeve, atë të Bushatit dhe gjithçka tjetër përfundonte në sheshe malesh me plehra, që gjithmonë e më shumë po bëheshin një makth që nuk donim t'ia pranonim vetes.

Tani kjo nuk ka as të majtë e as të djathtë, as lart e as poshtë; mbetje prodhojmë të gjithë dhe të gjithë kemi detyrë të interesohemi dhe të kuptojmë se çfarë ndodh me mjedisin rreth nesh, në mos për njëritjetrin, për fëmijët tanë. Në vitin 2013, në mandatin e parë të kësaj qeverie, dëshira për të punuar dhe për t'i zgjidhur problematikat e trashëguara në dekada, renditet ndër prioritetet kryesore të programit të qeverisjes si vëmendje ndaj qytetarëve dhe si vëmendje ndaj mjedisit dhe të ardhmes. Duke e trajtuar edhe si emergjencë mjedisore, edhe si analizë të thellë të situatës, Ministria e Zhvillimit Urban në vitet 2014-2016 ka bërë një skanim të parë të territorit, duke identifikuar rreth 100 venddepozitime skandaloze mbetjesh në territor. Filluan investimet serioze në infrastrukturën e trajtimit fundor të mbetjeve që nga qarku i Korçës deri në "Ekoparkun e PortoRomanos" dhe sot kemi impiante të trajtimit të mbetjeve në shumicën e zonave dhe parashikohet të vijohet, edhe mbi bazën e studimeve të fizibilitetit të mbështetura nga fonde të Bashkimit European, më tej në qarqet e Gjirokastrës, të Kukësit dhe të Dibrës, të vetmet që kanë ngelur pa një impiant fundor të trajtimit të mbetjeve, kusht i domosdoshëm për të folur për menaxhim të integruar të mbetjeve, sepse t'i hedhësh thjesht nëpër brigje, do të thotë thjesht që i kemi hedhur, por nuk kemi menaxhuar asgjë. Ka vijuar ky identifikim dhe ky skanim i territorit, i venddepozitimeve ilegale në territor, kusur që na i la ndarja administrative në komuna që, siç masakruan territorin me ndërtime kuturu, masakruan edhe tokën, pyllin, përrenjtë, lumenjtë e më tej detin, se aty përfundojnë të gjitha.

Në vitin 2018 Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit bëri një tjetër studim dhe botoi një raport me 199 venddepozitime të tilla, të identifikuara në të gjithë territorin, pjesë e një plani, që po evadohen gradualisht drejt këtyre pikave fundore, sepse, edhe t'i hiqje, lindte pyetja se ku do t'i çoje, siç pyesin shpesh vullnetarët, të cilët na ndihmojnë dhe na mbështesin në këtë punë e thonë: "Mirë i mblodhëm thasët, po ku do të shkojmë?" Është jo më pak e rëndësishme edhe kjo punë që kemi nisur tani, plani i pastrimit kombëtar, i cili, duam apo nuk duam ne, e shohim apo nuk e shohim, merremi apo nuk merremi me debatet e çatrafilosura të llogarive politike, zhvillohet çdo ditë në territorin e Shqipërisë nga të gjitha stafet e bashkive. Sikur ta kishim nisur që në fillim këtë punë kështu, ndoshta nuk do t'i kishim këta çibanë nëpër tokë, por më mirë vonë se kurrë. Rëndësi ka që kjo shërben jo vetëm për menaxhimin e mbetjeve, ku janë kryer investime dhe reforma, por edhe për ndërgjegjësimin, sepse, në fakt, pjesë e një reforme të tillë ishte edhe ndarja territoriale duke i fuqizuar bashkitë me dhënien e kompetencave, si përgjegjëse për administrimin e territoreve, duke përfshirë edhe menaxhimin e mbetjeve. Nëpërmjet dy vendimeve shumë të rëndësishme të Këshillit të Ministrave të vitit të kaluar,

gjetëm një metodologji të saktë, e cila shërben për llogaritjen e kostos së shërbimit që ndikon në përmirësimin e tarifave, por edhe një tjetër për të llogaritur metodologjinë për të kuptuar sa gjenerojmë, sa kushton çdo ton dhe si duhet ta llogaritë çdo bashki. Thënë kjo, të gjitha i binden një parimi: ndotësi paguan. E rëndësishme është që ne e kemi të planifikuar tashmë me strategji, me masterplan dhe me plan veprimi për një periudhë që shkon nga 15 deri në 20 vjet dhe për këtë mjafton të shikojmë punët e bëra, rehabilitimin e shumë pikave nëpër bashki, që nga Çorovoda e deri në Gjirokastër, ku po punohet tani; që nga Kukësi e deri në Burrel. Por dua të ndaj me ju një informacion të fundit, zonja Kryetare, se ndoshta u intereson të gjithëve, sepse hallet nuk zgjidhen me kaq, por kemi një ndërgjegjësim. Të gjitha bashkitë, të 61 bashkitë, këtë vit e kanë konsideruar prioritet, sepse, sigurisht, të gjithë nuk kemi qenë aspak të kënaqur kur Himara ishte e mbushur me thasë plehrash që hidheshin nga bizneset, kur Kavaja pyllin e kishte të papastër. Të gjitha bashkitë e kanë buxhetuar me prioritet dhe 50 milionë euro është shuma totale e buxhetimit të menaxhimit të mbetjeve nga bashkitë, të miratuara nga këshillat bashkiakë. Krahasuar me vitin e kaluar, është rreth 10 milionë euro më shumë për të pasur një Shqipëri më të pastër, sepse sot Tirana është më e pastër, Durrësi është më i pastër, Elbasani është më i pastër, Fieri është më i pastër, por nuk i kemi zgjidhur të gjitha. Prandaj, nëse mjedisin e konsiderojmë prioritet, nëse mbetjet dhe menaxhimin e tyre i konsiderojmë prioritet, kjo shprehet edhe në buxhet. Faleminderit!